

V E N D I M
Nr. 460, datë 17.8.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 339, DATË 5.6.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.393, DATË 3.9. 1992, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE""**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I.

1. Në vendimin nr.339, datë 5.6.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore"", pas fjalëve "Drejtorisë së Programit dhe Koordinimit" shtohen fjalët "Sekretariati shqiptar për Paktin e Stabilitetit".

2. Efektet financiare prej 5000 mijë lekësh, që do të përdoren për shpenzimet e pagave, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative, të përballohen nga buxheti i shtetit i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe të Tregëtisë.

3. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta